

ECURIA E SHQIPËRISË NË ZBATIMIN E REFORMAVE PËR *CLUSTER ONE*

Nga Gevin Sherko

Hyrje

Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian është i vetmi subjekt ku vëzhgohet dukshëm një konsensus ndërpartiak. Kjo ambicie filloi me Lëvizjen Studentore të vitit 1991 nën parullën “*E duam Shqipërinë si gjithë Evropa!*”. Pas Samitit të Selanikut në vitin 2003, ku Ballkanit Perëndimor iu dha një “perspektivë evropiane”, Shqipëria ndjeu për herë të parë se po i afrohej Evropës jo vetëm shpirtërisht, por edhe politikisht. Kjo valë optimizmi u fuqizua më tej pas zgjerimit të njohur si “*Zgjerimi i Madh*” (Big Bang), kur Bashkimi Evropian vendosi të anëtarësonte njëkohësisht 10 vende të reja nga Evropa Qendrore dhe Lindore (Çekia, Estonia, Qipro, Letonia, Lituania, Hungaria, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia). Pak vite më vonë, në vitin 2007, Bullgaria dhe Rumania u bënë gjithashtu pjesë e Bashkimit Evropian.

Fatkeqësisht, ky optimizëm politik rezultoi jetëshkurtër, kryesisht për shkak të rrethanave që u zhvilluan pas raundeve të zgjerimit 2004-2007. Shenjat e para të hezitimit ndaj zgjerimit të mëtejshëm në Ballkanin Perëndimor filluan të shfaqeshin. Bashkimi Evropian nisi të ndërgjegjësohej për koston e vendimit të zgjerimit të vitit 2004, kur dolën në pah vështirësi të mëdha për të përshtatur institucionet evropiane me qëllim që të funksiononin për të gjitha 28 shtetet anëtare. U vu në provë ajo që njihet si “kapaciteti i përthithjes” (*absorption capacity*) i Bashkimit Evropian, i cili përcaktohet si aftësia e BE-së për të pranuar anëtarë të rinj në një moment të caktuar pa rrezikuar objektivat politike dhe institucionale të përcaktuara nga Traktatet.

Ky proces i vështirë “*përthithjeje*” krijoi ndjesinë që njihet si “*lodhja nga zgjerimi*” (*enlargement fatigue*). Një faktor tjetër thelbësor që theksoi këtë “*lodhje*” ishin gjithashtu pasojat e krizave financiare në vitin 2008 dhe kriza greke në vitin 2014, e cila e bëri opinionin

publik dhe shtetet anëtare më të rezervuara ndaj zgjerimit, pasi mbështetja publike për këtë politikë gjatë asaj kohe ra ndjeshëm.

Megjithatë, Bashkimi Evropian mbeti i vendosur, edhe pse në një masë më të vogël se në vitin 2004, për të integruar Ballkanin Perëndimor, kryesisht për dy arsye:

- 1) lidhja historike e rajonit me kontinentin evropian;
- 2) për të mbrojtur rajonin nga ndikimet dashakeqe (Rusia, Kina, Arabia Saudite), veçanërisht pas luftërave në ish-Jugosllavi.

Pasiguria e shkaktuar nga luftërat në ish-Jugosllavi duhej të zëvendësohej nga nocioni i “evropianizimit”, që nënkupton ndryshimin e mënyrës së të menduarit dhe të vepruarit në Ballkanin Perëndimor sipas një agjende të qartë rregullash dhe standardesh. Megjithatë, qasja e Bashkimit Evropian ndryshoi rrënjësisht. Në vend të qasjes së “grupimit”, BE-ja vendosi të aplikojë qasjen e njohur si “*Parimi i Regatës*”, pra kush përparon i pari, hyn i pari. Kroacia është i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor që pati sukses nën këtë qasje.

Ndërkohë, 6 vendet e tjera (Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Bosnja, Maqedonia e Veriut dhe Serbia), që nga viti 2020, i janë nënshtruar një metodologjie të re. Sipas metodologjisë së mëparshme, Komisioni Evropian dhe vendi kandidat negocionin 35 kapitujt e “*acquis communautaire*” individualisht ose paralelisht. Problemi me këtë metodologji, sipas Komisionit Evropian, ishte se aspektet themelore që lidhen me funksionimin e institucioneve demokratike mund të minimizoheshin përballë çështjeve teknike të “*acquis communautaire*”. Për këtë arsye, metodologjia e re propozon grupimin e të gjithë 35 kapitujve në 6 blloqe tematike (*clusters*).

Këto janë:

1. Themeloret
2. Tregu i brendshëm
3. Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse
4. Agjenda e gjelbër dhe zhvillimi i qëndrueshëm
5. Burimet natyrore, bujqësia dhe kohezioni
6. Marrëdhëniet dhe politikat e jashtme

Blloku i parë, “Themeloret”, përfshin kriteret politike – konkretisht funksionimin e institucioneve demokratike, gjyqësorin, drejtësinë – si dhe kriteret ekonomike. Ky bllok quhet “Themelor” pasi hapet i pari dhe mbyllet i fundit. Progresi në këtë bllok do të përcaktojë ritmin e përgjithshëm të negociatave. Sipas metodologjisë së re, Shqipëria ka

hapur 4 blloqe tematike (Themeloret, Marrëdhëniet dhe Politikat e Jashtme, Tregu i Brendshëm dhe Agjenda e Gjelbër) me synimin që t'i hapë të gjitha blloqet deri në fund të vitit 2025 dhe t'i mbyllë ato në vitin 2027. Në këtë raport, synohet të analizohet progresi i Shqipërisë në zbatimin e reformave të nevojshme për grupkapitullin e parë gjatë periudhës Qershor 2025.

Metodologjia

Metodologjia që është përdorur në këtë raport përfshin mbledhjen e të dhënave dhe më pas analizën e tyre përmes një table të dhënash. Metoda e mbledhjes së të dhënave ka qenë kërkimi nëpërmjet burimeve dokumentare (*desk research*). Burimet kryesore të të dhënave për këtë raport përfshijnë Agjendën Kombëtare të Reformave, Udhërrëfyesin e Qeverisë Shqiptare për funksionimin e institucioneve demokratike, dokumentin jozyrtar (*non-paper*) të Këshillit të Bashkimit Evropian mbi progresin e Shqipërisë në Grupkapitullin e parë, si dhe raportet e progresit të hartuara nga Komisioni Evropian. Analiza e të dhënave është realizuar përmes analizës tematike të të dhënave primare të marra nga këto burime.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË NEGOCIATAVE TË SHQIPËRISË

Hapat e parë konkrete të Shqipërisë drejt integritimit evropian nisën në prill të vitit 2009, kur Shqipëria dorëzoi zyrtarisht aplikimin për anëtarësim në BE. Pas një procesi të vështirë, i karakterizuar nga konflikte partiake të brendshme dhe disa kërkesa nga vendet anëtare të BE-së, Shqipërisë iu dha statusi i vendit kandidat në vitin 2014 nga Këshilli i Bashkimit Evropian. Gjashtë vite më vonë, në vitin 2020, negociatat e anëtarësimit u hapën pas vetove franceze dhe holandeze të vitit 2019. Holanda vuri veton ndaj Shqipërisë për shkak të shqetësimeve lidhur me rritjen e kriminalitetit, ndërsa vetoja franceze kishte një natyrë më institucionale. Presidenti Macron kërkonte së pari reformimin rrënjësor të institucioneve evropiane përpara çdo zgjerimi të mëtejshëm.

Deri në vitin 2024, Shqipëria përparoi përkrah Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, rrugët e dy vendeve filluan të ndahen. Maqedonia e Veriut ngeci në procesin e saj të negociatave pas një konflikti me Bullgarinë lidhur me përfshirjen e pakicës bullgare në kushtetutën e saj. Kjo e penalizoi në mënyrë të konsiderueshme Shqipërinë, e cila po demonstronte progres të dukshëm. Qëllimi i qeverisë shqiptare është të mbyllë të gjitha grup kapitujt deri në vitin 2027 dhe të synojë anëtarësimin në BE në vitin 2030.

Gjatë Samitit BE–Ballkani Perëndimor të mbajtur në Shkup, Komisionerja për Zgjerimin, Marta Kos, deklaroi se Shqipëria është në rrugën e duhur për të përmbushur këtë ambicie, ndërkohë që theksoi nevojën për unitet politik për realizimin e reformave të nevojshme. Në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë, dy çështje theksohen veçanërisht: korrupsioni dhe reforma në drejtësi.

Në këtë drejtim, Kuvendi i Shqipërisë miratoi në vitin 2016 amendamente kushtetuese që nisën një reformë madhore në sistemin gjyqësor përmes një procesi të thelluar vetingu. Ky proces çoi në shkarkimin e disa gjyqtarëve, kryesisht për shkak të korrupsionit dhe lidhjeve me organizatat kriminale. Një pikë kyçe e kësaj reforme në drejtësi është krijimi i Strukturës së Posaçme Antikorrupsion (SPAK). SPAK ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për luftimin e korrupsionit në nivelet më të larta, duke hetuar dhe ngritur akuza ndaj ish-ministrave, ish-kryeministrave, presidentëve dhe kryetarëve të bashkive. Megjithatë, skepticizmi ende mbizotëron, pasi janë dokumentuar përpjekje nga elita politike për të mbrojtur figura të rëndësishme nga llogaridhënia.

Një tjetër problem i rëndësishëm është liria e medias. Edhe pse në parim liria e medias mbrohet nga ligji, raportet e progresit nga Komisioni Evropian, raporti paraprak i fundit nga OSBE mbi Zgjedhjet e Përgjithshme të 11 Majit si edhe raporti i fundit i Komisionit Evropian për shtetin e së drejtës në Shqipëri evidentojnë probleme lidhur me pronësinë jo-transparente të mediave dhe ndikimin e fshehur politik.

Për të ndihmuar më tej procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, Komisioni Evropian miratoi Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor. Objektivat e këtij plani janë konvergjenca ekonomike mes rajonit dhe Bashkimit Evropian, bashkëpunimi rajonal dhe përsheptimi në zbatimin e reformave të nevojshme. Në prill 2025, Shqipëria përfitoi nga para-financimi duke marrë 64.5 milionë euro (grante dhe hua me kushte të favorshme). Në dekadën e ardhshme, Shqipëria pritet të përfitojë 1 miliard euro nga Plani i Rritjes.

Tabela

Tabela 1: Agjenda Kombëtare e Reformave

Reformat Kombëtare - Grupkapitulli 1: Themeloret			
Reforma - Rezultati	Afatet	Progresi	Institucionet përgjegjëse
5.1.1: Krijimi i ZRA-se si Njësi Kombëtare Koordinuese dhe pikë kontakti rajonal/ndërkombëtar ● Paraqitja e aplikimit për t'u anëtarësuar ne Rrjetin Evropian te ZRA-ve ● Miratimi i akteve nënligjore për ligjin e miratuar për ZRA-ne përmes udhëzimeve te eksperteve te KiE-se.	(Qershor 2025)	Aktualisht nuk ka asnjë akt ligjor ne fuqi. Nuk ka asnjë aplikim ne Rrjetin Evropian te ZRA-ve (Carin). Nga non-paper-i - Zyra e Rikuperimit të Aseteve u krijua në 2023 bazuar nga një urdhër i Ministrit të Brendshëm në Dhjetor 2023. Kjo zyrë ka 4 punonjës. - Miratimi i ligjit për ZRA-në ka rëndësi parësore.	Ministria e Punëve të Brendshme
5.2: Bashkëpunimi në	(Qershor 2025)	SPH-ja u themelua në	Ministria e

Reformat Kombëtare - Grupkapitulli 1: Themeloret

fushën e drogës		Dhjetor 2024 si një degë brenda Policisë së Shtetit.	Punëve të Brendshme.
5.2.1: Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe kuadrit strategjik me synimin për zvogëlimin e ofertës dhe kërkesës për droga të paligjshme. Hapi 2: Hartimi i bazës rregullatore dhe procedurave të funksionimit për Sistemin Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm (SPH).		Non-Paper: - Shqipëria pritet që të fuqizojë kapacitetet e SPH-së duke shtuar burimet e saj.	
5.1.2: Forcimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë raste të nivelit të lartë. Hartimi i një raporti vlerësimi te Strategjisë aktuale kundër Krimit te Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 Hapi 2: Zgjerimi i aksesit dhe ndërveprimit të bazave të dhënave dhe përdorimi i mjeteve të IT-së në luftën kundër krimit të organizuar: - Identifikimi i bazave të reja të dhënave të aksesueshme nga autoritetet ligjzbatuese.	(Qershori 2026)	Aktualisht nuk ka vlerësim.	Ministria e Punëve të Brendshme
	(Qershori 2025)	Nuk ka hartëzim të dhënave të aksesuara nga PSH-ja.	

Reformat Kombëtare - Grupkapitulli 1: Themeloret

5.4.1: Konsolidimi i pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit nëpërmjet transparencës. Hapi I: Ndjekja efektive gjyqësore për rastet e vetting-ut që rezultojnë me dyshime për elementë kriminalë që vazhdojnë t'i referohen prokurorisë Hapi III: Këshillat e Lartë Gjyqësor dhe të Prokurorisë sigurojnë transparencë të lartë, ndajnë publikisht të gjithë informacionin në lidhje me emërimet, ngritje në detyrë dhe transferimet si dhe nivelin e zbatimit të inspektimeve tematike nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë. Publikimi nga Këshillat e Lartë Gjyqësor dhe të Prokurorisë i të dhënave të përgjithësuara për emërimet, gradimet dhe transferimet në gjyqësor. Publikimi nga Këshillat e Lartë Gjyqësor dhe të Prokurorisë i të dhënave të përgjithësuara për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të inspektimeve tematike nga ILD-ja.	(Qershor 2025) (Qershor 2025) (Qershor 2025, vijueshmëri) (Qershor 2025, vijueshmëri)	34 raste referimi nga KPK-ja në Prokurori në vitin 2023.	Ministria e Drejtësisë, KPK dhe Dhoma e Apelit Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë.
---	---	---	--

Reformat Kombëtare - Grupkapitulli 1: Themeloret			
5.4.2: Rritja e efikasitetit të gjyqësorit në të gjitha nivelet. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton dhe zbaton në mënyrë efektive një udhërrëfyes gjithëpërfshirës për të rritur efikasitetin dhe për të reduktuar numrin e çështjeve të pashqyrtuara sipas instrumentit CEPEJ.	(Qershor 2025)	Udhërrëfyes për të rritur efikasitetin dhe për të reduktuar çështjet e mbartura të KLGJ-së.	Këshilli i Lartë Gjyqësor
5.5: Lufta kundër korrupsionit Rritja e transparencës: Publikimi i të gjithë të dhënave të ILDKPKI në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit.	(Dhjetor 2024)	Ka një sistem elektronik të deklarimeve të pasurisë i cili administrohet nga ILDKPKI.	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin
5.6.1: Forcimi i lirisë së shprehjes, në përputhje me standardet evropiane Rritja e kapaciteteve të organeve ligj zbatuese për të trajtuar rastet e dhunës ku përfshihen gazetaret.	(Qershor 2025)	75 oficerë policie janë trajnuar për mbrojtjen e gazetarëve.	Ministria e Drejtësisë

Tabela 2: Udhërrëfyesi për funksionimin e Institucioneve Demokratike

1. Procesi Zgjedhor	
1.1: Zgjedhje te lira dhe te ndershme	Kuadri ligjor qe adreson rekomandimet e pazgjidhura te OSBE-ODIHR dhe te Komisionit te Venecias miratohet përmes një konsensusi ndërpartiak brenda vitit 2026: - Zbatimin e parimit te mundësive te barabarta dhe trajtimit te barabarte para ligjit dhe profesionalizimit te administratës zgjedhore - Sigurimin e depolitizimit te komisioneve zgjedhore te niveleve me te ulëta. - Votimin e shtetasve shqiptare me banim te përhershëm jashtë territorit - Akuzat për blerje votash, për keqpërdorim dhe shpërdorim te burimeve administrative qendrore dhe vendore.
1.2: Media në fushatën zgjedhore	Ndryshime legislative në Kodin Zgjedhor brenda vitit 2026 përmes një konsensusi të gjerë ndërpartiak: - Garantim i mundësive te barabarta për t'u qasur në media. - Kufizim i mbulimit të fushatës me materiale të ofruara nga partitë.
1.3: Financimi i partive politike dhe fushatës zgjedhore	Ndryshim ne Kodin Zgjedhor në përputhje me rekomandimet e OSBE-ODIHR brenda vitit 2027: - Zgjerim i rregullave dhe kufizimeve për donacionet dhe shpenzimet për palët e treta. - Publikimi nga partitë i të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës së tyre.

2. Funksionimi i Parlamentit	
2.1: Transparenca dhe llogaridhënia	Ndryshimi i Kodit të Sjelljes së deputeteve miratohet duke parashikuar takime vetëm me OSHC-të dhe lobistët e regjistruar. Ndryshimi i rregullores së Kuvendit duke shtrirë kontrollin post-legjislativ jo vetëm mbi ligjet e përafruara me <i>acquis</i> të BE-së por edhe me aktet normative që kanë fuqinë e ligjit deri në vitin 2024.
2.2: Integriteti	Harmonizim i plotë me standardet ndërkombëtare për luftimin e ryshfetit të zyrtarëve publikë nëpërmjet ratifikimit të Konventës së OECD-së për Luftimin e Ryshfetit brenda vitit 2027. Standarde më të larta etike të deputetëve në përputhje me praktikën e shteteve anëtare të BE-së të siguruara deri në vitin 2027.

Me referencë të Tabela 1, një komponent që bie në sy është lufta kundër krimit të organizuar. Në këtë drejtim, Shqipëria miratoi një Strategji Kombëtare për Luftën kundër Krimit të Organizuar për periudhën 2021-2025. Vlerësimi i kësaj strategjie pritet të bëhet nga Ministria e Brendshme deri në qershor 2026. Megjithatë, Policia e Shtetit ende has vështirësi në hartimin e kapaciteteve të saj IT për luftën kundër krimit të organizuar. Një nga politikat kyçe që Komisioni Evropian thekson është miratimi i shpejtë i Zyrës për Rikuperimin e Aseteve (ZRA), një strukturë brenda Policisë së Shtetit e cila do të jetë thelbësore në identifikimin dhe konfiskimin e pasurive kriminale.

Në Agjendën e Reformave, ishte parashikuar që deri në qershor 2025 të krijohej ZRA dhe të aplikohet për anëtarësim në rrjetin evropian të Zyrave për Rikuperimin e Aseteve deri në dhjetor 2025. Për të përmbushur këtë afat, kërkohej miratimi i ligjit për ZRA-në. Një projektligj u dorëzua në Kuvendin e Shqipërisë për konsultim në mars 2023, por nuk pati përparim për miratimin e tij deri në afatin e qershorit 2025. Si pasojë, aplikimi për anëtarësim në rrjetin

evropian të ZRA-ve mund të shtyhet. Sipas Komisionit Evropian, ligji për ZRA-në duhet të miratohet pa vonesë.

Një tjetër komponent i theksuar në raportin e progresit të Komisionit është bashkëpunimi në fushën e drogës. Një nga detyrimet në këtë fushë është krijimi i një Sistemi Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm për identifikimin e substancave psikoaktive. Ministria e Brendshme e krijoi këtë sistem me një urdhër të Ministrit të Brendshëm në dhjetor 2024 dhe aktualisht ai përbëhet nga një drejtues njësie dhe dy ekspertë. Megjithatë, në dokumentin jozyrtar të majit të Këshillit të Bashkimit Evropian theksohet se nevojitet më shumë punë për të rritur burimet dhe kapacitetet e këtij sistemi sipas modelit të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm të BE-së.

Lufta kundër korrupsionit përbën një kërkesë thelbësore në negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë sa i përket grupkapitullit të parë. Gjatë pesë viteve të fundit, Komisioni Evropian e ka vlerësuar nivelin e përgatitjes së Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit nga “i pjesshëm” në “mesatar”. Kjo tregon progres të qëndrueshëm, por nevojitet vigjilencë. Për të forcuar luftën kundër korrupsionit, përfshirë në nivelet më të larta, Qeveria e Shqipërisë në Dhjetor 2024 miratoi Strategjinë Kombëtare Anti-Korrupsion për periudhën 2024-2030. Raporti i Komisionit Evropian për Shtetin e së Drejtës thekson se ky është një zhvillim pozitiv, mirëpo kapacitetet institucionale si edhe kuadri ligjor duhet përmirësuar pa vonesa.

Reforma në drejtësi është po aq e rëndësishme, pasi përbën një nga kriteret kyçe në vlerësimin e progresit në negociatat e anëtarësimit. Përmbushja e kriterëve në Kapitujt 23 (Drejtësia dhe të Drejtat Themelore) dhe 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria) përcakton ecurinë e përgjithshme të negociatave. Siç përcakton Kuadri i Negociatave, asnjë grupkapitull nuk mund të mbyllet pa përmbushjen e këtyre kriterëve.

Një reformë e rëndësishme e përfshirë në Agjendën Kombëtare të Reformave është rritja e efektivitetit të sistemit të drejtësisë në të gjitha nivelet. Për të arritur këtë, Këshilli i Lartë Gjyqësor pritej të miratonte deri në qershor 2025 një udhërrëfyes për rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë në përputhje me standardet e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ). Udhërrëfyesi është hartuar dhe miratuar dhe mbulon periudhën 2025–2027. Ky është vlerësuar si një zhvillim pozitiv nga Komisioni Evropian, i cili argumenton se ajo përfaqëson një progres të rëndësishëm në zbatimin e reformës në drejtësi dhe rritjen e autonomisë së prokurorisë.

Megjithatë, pavarësisht këtij progresi, problemet vazhdojnë. Këshilli i Bashkimit Evropian ka vënë re përpjekje të vazhdueshme nga zyrtarë publikë për të ndërhyrë dhe ushtruar presion mbi sistemin gjyqësor. Kjo retorikë u vu re disa herë edhe gjatë 2025, kur arrestimi, hetimi

ose masa të SPAK/GJKKO kundër korrupsionit të zyrtarëve të lartë nxiti përpjekje të paprecedentë ndërhyrjeje nga zyrtarë të zgjedhur dhe retorikë denigruese, përfshirë edhe Kryeministrin dhe anëtarë të kabinetit ekzekutiv. E njëjta gjë vlen edhe për kampin opozitar. Në të dyja këto raste, shihet qartë se elitat politike, edhe me institucionet e reja të drejtësisë, ende përpiqen të mbrojnë dhe të përjashtojnë veten nga llogaridhënia.

Me referencë të Tabela 2 dhe më konkretisht procesi zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve themeloi në janar 2025 Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER) me qëllim mundësimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit. Një muaj më pas, në përputhje me Udhërrëfyesin e Qeverisë për Funksionimin e Institucioneve Demokratike, Kuvendi i Shqipërisë arriti një konsensus ndërpartiak për të miratuar ndryshime kushtetuese që synonin lehtësimin e votimit nga jashtë vendit. Ky hap u vlerësua pozitivisht nga Komisioni Evropian. Ndryshime të tjera ligjore që kërkojnë rritjen e efikasitetit dhe pavarësisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) pritet të miratohen në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias brenda vitit 2026.

PËRFUNDIM

Periodha e monitorimit ka treguar se Shqipëria ka bërë një progres të qëndrueshëm, por sfida të rëndësishme mbeten. Sfida më evidente e identifikuar në këtë raport përgjatë kësaj kornize kohore është miratimi i ligjit për ZRA-në. Edhe pse ky ligj është diskutuar në Komisionin Parlamentar për Integrimin Evropian dhe është vlerësuar se nuk bie ndesh me Kushtetutën e Shqipërisë dhe përputhet me “*acquis communautaire*”, ai ende nuk ka kaluar për votim në Parlament. Fusha të tjera që kërkojnë përmirësim sipas raportit janë pavarësia e AMA-s dhe reforma zgjedhore.

Nëse Shqipëria do të anëtarësohet në Bashkimin Evropian deri në vitin 2030 mbetet një perspektivë për të cilën është ende herët të thuhet nëse është e realizueshme apo jo. Deri më tani, duket se këto objektiva vendosen më shumë për qëllime politike të brendshme – siç u demonstrua edhe nga premtimi kryesor elektoral i Partisë Socialiste – sesa si qëllime konkrete me afate dhe rezultate të matshme. Për të realizuar këtë vizion, Shqipëria duhet të vazhdojë të adresojë çështje si korrupsioni, reforma në drejtësi dhe procesi zgjedhor, duke përdorur instrumente si Agjenda Kombëtare e Reformave dhe Plani i Rritjes. Megjithatë, një kujtesë thelbësore për qeverinë shqiptare është se anëtarësimi në Bashkimin Evropian nuk është një rrugë njëdrejtimore.

Bashkimi Evropian, njëkohësisht, duhet të përgatisë popullsinë e vet për pranimin e anëtarëve të rinj si Shqipëria në bllok. Opinioni publik dhe kohezioni i brendshëm për çështjen e zgjerimit në BE janë po aq të rëndësishme për përmbushjen e procesit të anëtarësimit deri në vitin 2030. Kjo pikë e fundit ngre një pyetje thelbësore që duhet shqyrtuar me kujdes: “A do të jetë vetë BE-ja e gatshme kur Shqipëria të jetë në portat e anëtarësimit, pavarësisht nëse kjo ndodh në 2030 apo më vonë?”

BIBLIOGRAFI:

- Kamberi , Geron. “Nga Historia Tek Metodologjia e Re e Zgjerimit Të Be: Një Metodologji Më e ‘Zgjuar’ Apo Më E ‘Zgjatur.’” *Cluster 1 Albania*, 25 Feb. 2022, cluster1albania.com/sq/nga-historia-tek-metodologjia-e-re-e-zgjerimit-te-be-nje-metodologji-me-e-zgjuar-apo-me-e-zgjatur/.
- European Commission. *Commission Staff Working Document: Albania 2024 Report*. SWD(2024) 690 final, 30 Oct. 2024, enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf.
- European Commission. *Commission Staff Working Document: 2024 Rule of Law Report – Country Chapter on the Rule of Law Situation in Albania*. SWD (2024) 828 final, 24 July 2024, commission.europa.eu/document/download/0154dce1-5026-45de-8b37-e3d56eff7925_en?filename=59_1_58088_coun_chap_albania_al.pdf
- European Parliament, *European Parliament Resolution of 9 July 2025 on the 2023 and 2024 Commission Reports on Albania (2025/2017 (INI))*, 9 July 2025, https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-10-2025-0155_EN.pdf
- OSCE Parliamentary Assembly. *Statement of Preliminary Findings and Conclusions: Albania – Parliamentary Elections*, 11 May 2025. 2 July 2025, OSCE Parliamentary Assembly, www.oscepa.org/en/documents/election-observation/election-observation-statements/albania/statements/5217-2025-parliamentary/file.
- Directorate-General for Justice and Consumers. *2025 Rule of Law Report: Communication and Country Chapters*. European Commission, 8 July 2025, commission.europa.eu/publications/2025-rule-law-report-communication-and-country-chapters_en
- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. *Raport i Komisionit për Çështjet Europiane*. 25 June 2025, <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202506251303249796Raport%20i%20Komisionit%20p%C3%ABr%20%C3%87%C3%ABshtjet%20Europiane.pdf>
- Gjoka, Blerina. “EU Raises Serious Concerns over Albania Government Attack Against Justice.” *Balkan Insight*, 18 June 2025, www.balkaninsight.com/2025/06/18/eu-raises-serious-concerns-over-albania-government-attack-against-justice/